



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 shkurt 2012
Nr. ref.: RK191/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 64/11

Parashtruesi

Feti Gashi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev. Nr. 184/2008, të 27 janarit 2009**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Feti Gashi nga fshati Mramor, Hajvali.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 184/2008, të 27 janarit 2009, duke pohuar që i është cenuar e drejta e punës sipas nenit 49 të Kushtetutës.
3. Më 19 dhjetor 2009, parashtruesi kishte dorëzuar një kërkesë tjetër në Gjykatë për të njëjtën çështje. Kjo kërkesë ishte regjistruar me Nr. KI 74/09.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 15 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues dhe propozimit të Kolegjit shqyrtues për kërkesën e regjistruar me Nr. KI 74/09, Gjykata konstatoi që kërkesa ishte e papranueshme për shkak se nuk ishte parashtruar brenda afatit katër mujor në përputhje me nenin 49 të Ligjit.
6. Më 12 maj 2011, parashtruesi dorëzoi një kërkesë të re në Gjykatë, tani të regjistruar me Nr. KI 64/11.
7. Më 17 gusht 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj.
8. Më 18 janar 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës kishte kontratë pune me KEK-un, e cila u ndërpre më 24 prill 2006. Në të vërtetë, Komisioni Disiplinor i KEK-ut nxori një vendim me të cilin konstatoi që parashtruesi i kishte shkelur detyrat e tij të punës.
10. Në qershor të vitit 2006, parashtruesi, në përpjekje të mbrojtjes së interesave dhe të drejtave të tij, të cilat pohonte se i ishin cenuar, inicioi procedurë gjyqësore në Gjykatën Komunale në Lipjan, duke vazhduar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe në Gjykatën Supreme.
11. Në të vërtetë, më 27 janar 2009, Gjykata Supreme (Rev. Nr. 184/2008) i anuloi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Komunale duke e mbështetur largimin e parashtruesit nga punësimi në KEK. Gjykata Supreme konstatoi që gjykatat gabimisht e kishin zbatuar të drejtën materiale kur kishin konsideruar se padia e parashtruesit ishte e bazuar.
12. Më 16 mars 2009, parashtruesi i shkroi letër kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, me të cilën kërkonte ndryshimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Parashtruesi thotë që kurrë nuk ka marrë përgjigje nga EULEX-i.

Vlerësimi i pranueshmërisë

13. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën 74/09 në Gjykatë më 19 dhjetor 2009. Si u përmend më lart, më 16 mars 2009, ai i shkroi letër kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it. Pra, letra drejtuar kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it ishte dorëzuar para parashtrimit të kërkesës 74/09 në Gjykatë.
14. Edhe pse ajo letër nuk ishte përmendur në kërkesën e mëhershme 74/09, kërkesa e re 64/11 bazohet vetëm në letrën e paraqitur nga parashtruesi si fakt i ri i parashtruar për këtë rast.
15. Parashtruesi konsideron që kërkesa e tij e mëparshme, e regjistruar me Nr. 74/09, ishte parashtruar me kohë duke pasur parasysh faktin që letrën e tij ia dërgoi kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it më 16 mars 2009 dhe pasi që ende është në pritje të përgjigjes nga EULEX-i.
16. Sa u përket kritereve për pranueshmëri, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (e) të Rregullores së punës, i cili thotë që kërkesa mund të konsiderohet e papranueshme nëse *“gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri”*.
17. Gjatë zbatimit të këtij rregulli për këtë rast, është me vend të shqyrtohet nëse kërkesa e parashtruesit ofron *“bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri”*.
18. Gjykata rikujton se parashtruesi pretendon që letra e tij drejtuar kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it është fakt i ri për qëllimet e një vendimi të ri, pasi ajo gjoja tregon se rasti ende nuk ka përfunduar.
19. Gjykata vëren që parashtruesi e bazoi kërkesën e tij drejtuar kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it në nenin 6, në lidhje me nenin 5 (6) të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.
20. Neni 6 (Dispozitat lidhur me Koordinatorin e EULEX-it për të Drejtat Pronësore në Kosovë) i ligjit të sipërpërmendur përcakton:

“6.1 Koordinatori i EULEX-it për të Drejtat Pronësore do të ndihmojë në koordinimin e çështjeve lidhur me të drejtat pronësore, si dhe zgjidhjen e kërkesave ndërmjet palëve të përfshira në këtë çështje, duke përfshirë por jo kufizuar në Agjencinë Kosovare të Pronës, Komisionin Kosovar për Kërkesa Pronësore, Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, gjykatat e rregullta, apo Shërbimin Policor të Kosovës.

6.2 Të gjitha palët që merren me çështjet e të drejtave pronësore, përfshirë këtu zgjidhjen e kërkesave në Kosovë, janë të obliguar që t'i ofrojnë falas Koordinatorit të EULEX-it për të Drejtat Pronësore çdo informatë të kërkuar nga ta dhe t'i lejojnë qasje në të gjitha elementet e nevojshme për zbatimin e mandatit të vet”.

21. Neni 5 (6) i të njëjtit ligj thotë:

“5.6 Në ushtrimin e funksionit të tyre të monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, gjyqtarët e EULEX-it do të kenë kompetencë që të kërkojnë me shkrim informata lidhur me statusin e çdo lënde civile në procedurë apo të përfunduar që është në juridiksionin ose kompetencën e cilësdo gjykate në Kosovë. Gjyqtarët e EULEX-it do të

kenë të drejtë që t'i marrin kopjet e duhura të dokumenteve që kanë të bëjnë me çdo kontest apo procedurë civile që janë në juridiksionin ose kompetencën e cilësdo gjykatë në Kosovë”.

22. Parashtruesi nuk ka marrë përgjigje në kërkesën e tij drejtuar EULEX-it dhe nuk është i sigurt nëse kërkesa e tij është regjistruar si rast në pritje për t'u zgjidhur pranë EULEX-it.
23. Në anën tjetër, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës, i cili përcakton që *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*. Duket që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (Rev. Nr. 184/2008), i 27 janarit 2009, është i formës së prerë dhe detyrues (*res judicata*). Prandaj, përveç përmbarimit të tij, asnjë mjet tjetër juridik nuk është efektiv dhe në dispozicion kundër vlefshmërisë së tij.
24. Përveç kësaj, letra që parashtruesi ia ka dërguar kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it nuk është mjet juridik i paraparë me ligj dhe nuk e ka fuqinë të ndikojë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme.
25. Gjithashtu, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane, parashtruesit janë vetëm të obliguar t'i shterojnë mjetet juridike që janë në dispozicion në teori dhe në praktikë në kohën përkatëse, pra, mjetet që janë të qasshme, që sigurojnë kompensim lidhur me ankesat e tyre dhe që ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses (Aktgjykim i Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Sejđović kundër Italisë, Kërkesa nr. 56581/00 e 1 marsit 2006, paragrafi 46).
26. Letra që parashtruesi ia ka dërguar kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, rrjedhimisht nuk është në gjendje të sigurojë kompensimin që e kërkon parashtruesi i kërkesës dhe nuk ofron asnjë mundësi për sukses për të marrë një aktgjykim të favorshëm të Gjykatës Supreme.
27. Gjykata konkludon që kërkesa e regjistruar me Nr. 64/11, në përputhje me rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës, nuk ofron bazë të mjaftueshme për vendim të ri.
28. Prandaj, Gjykata mbron konkluzionin për papranueshmëri të arritur në aktvendimin e nxjerrë në lidhje me kërkesën 74/09, sepse, në përputhje me nenin 49 të Ligjit, kërkesa ishte dhe ende është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

